

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Mahir Tutuli, kryetar i kolegjit, Rafet Haxhaj dhe Qerim Ademaj, anëtarë në çështjen juridike të paditësit N.P.T “UKAB” me seli në Prishtinë, Rruga e Vjetër e Shkupit, fshati Llapna Sellë, të cilin me autorizim e përfaqëson A.S., avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Pro Credit Bank, sh.a., me seli në Prishtinë, të cilën me autorizim e përfaqëson S.S., avokate nga Prishtina, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, të paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike, III.C.nr.394/2013 të datës 19.10.2015, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 10.10.2017, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e paditësit N.P.T “UKAB” me seli në Prishtinë, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike, III.C.nr.394/2013, i datës 19.10.2015, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e atakuar, në paragrafin I të dispozitivit, e ka refuzuar në tërësi si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditësit N.P.T “UKAB” me seli në Prishtinë me të cilën ka kërkuar anulimin e kontratës me nr.CA-0308 e datës 24.10.2011 dhe ta detyroj të paditurën Pro Credit Bank sh.a me seli në Prishtinë që t`ia kthej vlerën e konfiskuar në shumë prej 12,217.36 euro, kompensimin e dëmit si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore, në afatin kohor prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, ndërsa në paragrafin II të dispozitivit, e ka detyruar palën paditëse N.P.T “UKAB” me seli në Prishtinë që në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore t`ia paguaj të paditurës Pro Credit Bank sh.a me seli në Prishtinë shumën e përgjithshme prej 1,226.00 euro.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë paditësi, me propozim që Gjykata e Apelit, ta aprovoj ankesën si të bazuar dhe aktgjykimin e atakuar të gjykatës së shkallës së parë, ta prish dhe lëndën ta kthejë në rigjykim dhe rivendosje në gjykatën e shkallës së parë.

Përgjigje në ankesë ka parashtruar i padituri me propozim që ankesa e paditësit N.P.T. “UKAB”, në këtë çështje juridike të refuzohet si e pabazuar, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike, III.C.nr.394/2013 i datës 19.10.2015, të vërtetohet.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë i shqyrtoi shkresat e lëndës , aktgjykimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, e pas vlerësimit të tyre në bazë të nenit 194 të LPK , gjeti se:

Ankesa është e pabazuar.

Paditësi N.P.T. "UKAB" me seli në Prishtinë, me datën 18.07.2013 ka parashtruar padi kundër të paditurës, Pro Credit Bank sh.a me seli në Prishtinë, duke kërkuar që e paditura t'ia kthejë vlerën e konfiskuar në shumë prej 12,217.36 € dhe anulim të kontratës me nr. CA-0308, e datës 24.10.2011, me pretendim për vlerësim të gabuar të gjendjes faktike, shkaktim të dëmit material dhe jomaterial dhe keqpërdorim të detyrës, me propozim që të aprovet kërkesëpadia e paditësit N.P.T "UKAB".

Gjykata e shkallës së parë pas administrimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, si kontrata për kredi me nr.10-079457 e dt.25.10.2011, kontrata mbi pengun e dt.25.10.2011, kontrata për dorëzani e dt.02.10.2011, certifikata e biznesit N.P.T "UKAB", lëvizja në llogarinë nga data 01.07.2014 deri me datën 14.07.2014, gjendja e paditësit nga data 01.07.2014 deri me datë 14.11.2013 si dhe dëgjimi i dëshmitarit H.B., ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar, andaj ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se, aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par 2. nën pikat b), g), j), k) dhe m) të LPK. Për shkak të zbatimit të rregullt të rregullave të procedurës kontestimore dhe për shkak të konstatimit të rregullt dhe të tërësishëm të gjendjes faktike, drejtë është zbatuar edhe e drejta materiale nga ana e gjykatës së shkallës së parë. Këto shkaqe ankimore i heton dhe vlerëson gjykata e shkallës së dytë sipas detyrës zyrtare e në bazë të nenit 194 të LPK.

Kjo gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar dispozitat materiale kur e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit sepse nga gjendja faktike, kjo gjykatë konsideron se nuk ekziston obligimi i së paditurës që paditësit t'ia shumë e kërkuar, nga arsyeja se paditësi me asnjë provë nuk i ka provuar pretendimet e tij. Këtë qëndrim gjykata e mbështet në dispozitat e Neneve 319.1 dhe 322.2 të LPK-së, të cilët parashohin se pala që pretendon se i takon një e drejtë ka për detyrë ta provojë faktin që është qenësor për realizimin e asaj të drejtë ndërsa në rastin konkret edhe pse paditësi në bazë të dispozitave të sipërcituara e ka pasur barrën që ta provojë se më të vërtet tërheqja e mjeteve e nga llogaria është bërë në mënyrë të kundërligjsjme, ai me asnjë provë nuk e ka dokumentuar demin e pësuar si dhe lartësinë e tij.

Gjykata i vlerësoi edhe pretendimet tjera të paditësit lidhur me gjendjen faktike, por gjeti se të njëjtat janë të pabazuara sepse gjykata e shkallës së parë në mënyrë të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike dhe ka dhënë arsye të plota për secilin pretendim të paditësit, e të cilat arsyetime i pranon plotësisht edhe Gjykata e Apelit, ndërsa pretendimet e të paditurës janë në kundërshtim me provat që gjenden në shkresat e lëndës.

Prandaj bazuar në të lartcekurat, kjo gjykatë vlerëson se aktgjykimi i atakuar i gjykatës së shkallës së parë nuk ka të meta për shkak të së cilave nuk mund të vlerësohet ligjshmëria e tij, dispozitivi i aktgjykimit është i kuptueshëm, nuk është në kundërtënie me vetveten ose me arsyet e aktgjykimit dhe se aktgjykimi përmban arsye të mjaftuara dhe bindëse për gjendjen faktike dhe juridike, për të vendosur në këtë çështje juridike, të cilat në tërësi i aprovon edhe Gjykata e Apelit.

Nga të cekurat u vendos si në dispozitiv në bazë të nenit 195.1 nën pikën d), e lidhur me nenin 200 të LPK .

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS ,
Ae.nr.26/2016, dt.10.10.2017.**

**KRYETARI I KOLEGJIT,
Mahir Tutuli, d.v.**